

KUSH JEMI

Nën dritën e situatës së rëndë që është duke përjetuar bota mbarë, Shoqatat “Donne di qua e di la”, dhe Skanderbeg, **me ndihmën dhe bashkëpunimin e Forumit Ndërfetar të Parmës dhe Grupit Kombëtar të Punës për “Dhomën e Heshtjes dhe/ose të Kulteve”**

kanë filluar projektin **“Përtej Emergjencës”**, sportel informues-orientues që vepron në një optikë shumëkulturore, shumëfetare apo laike dhe që ka si objektiv **të reduktojë çorientimin e personave duke u dhënë informacionet e përshtatshme, të përkthyer në gjuhë të ndryshme, për mundësitë e lidhura me administrimin e shtrimit në spital apo të humbjes së jetës** në këtë kontekst emergjence që ka pështjelluar praktikatat normale të ngarkuara me aq probleme rreth mundësisë për respektimin e traditave dhe ceremonive të veta.

Projekti synon **të kufizojë situatën e ankthit dhe të frikës, duke mbështetur personat** që janë duke vuajtur në vetmi dhe kanë frikë, për veten dhe të afërmit e tyre. Nëpërmjet shoqatave tona do të bëhet e mundur përfshirja e komuniteteve të diasporës, të para në kontekstin e afërsisë kulturore dhe afektive, implementimi përtej ndjenjës së përkatësisë edhe asaj të shtetësisë.

Propozimi ynë i hap rrugën specifikisht marrjes në ngarkim të personave që i përkasin komuniteteve të ndryshme fetare apo emigrantëve të qytetit të Parmës, personave të huaj të rrjeteve të pritjes, grupeve formale dhe informale të lidhura me traditat e shumta kulturore dhe fetare të cilët ndodhen në një gjendje pështjellimi dhe pafuqie

Sporteli ofron një shërbim me dobi publike, që administrohet nga profesionistë në marrëdhëniet e ndihmës, dhe nga ndërmjetës kulturorë që punojnë në respektim dhe për ngritjen e vlerës të dallimeve kulturore dhe fetare.

Çfarë duhet bërë në rast vdekje të një personi.

Një nga kapitujt më të dhimbshëm të vendimeve që qeveria është përpjekur të realizojë për të ulur në mënyrë efikase infektimet nga COVID-19 është ai i **varrimeve, që në thelb janë “të ndaluar” me vendim qeverie.**

Faktikisht rregullat e futura në Itali, janë shumë shtrënguese.

Vendimi përcakton që **në varreza mund të zhvillohet vetëm një ceremoni e shkurtër varrimi**, ashtu siç parashikohet nga rituali për varrim, por pa thënë meshën apo pa realizuar ceremoninë fetare. Gjatë kësaj ceremonie, ashtu siç është vendosur nga normativa, të pranishmit duhet të respektojnë distancën të paktën një metër larg njëri tjetrit. Asnjë mundësi për kortezh funeral në këmbë, si nga shtëpia ashtu edhe për në varreza në rastet e vdekjes për arsye të COVID-19. Personat që do të dëshironin të kujtonin të dashurin e tyre me një meshë varrimi, apo me ndonjë ceremoni tjetër fetare, e kanë të pamundur që ta bëjnë në këtë moment.

NËSE PERSONI KA VDEKUR NË SPITAL, POZITIV ME KORONAVIRUS, ÇFARË DUHET BËRË?

Duhet të kontaktosh shërbimin funeral që do të kontaktojë spitalin dhe do të të ndihmojë në këtë moment të vështirë dhe të dhimbshëm ku fatkeqësisht do të jesh i detyruar sërish të ndjekësh udhëzimin për të qëndruar në shtëpi. **Në asnjë rast, nuk imponohet kremimi.** Këto do të gjeni [listën e ndërmarrjeve funerale që punojnë në Parma dhe në provincë.](#) Në [këtë faqe](#) do të gjesh edhe kontaktet e dhomës së përmotshme të spitalit të Parmës që në këto ditë ka vënë në dispozicion edhe një numër celulari [334.5638730](tel:334.5638730).

Nëse ke nevojë të viresh në kontakt me komunitetin të cilit i përket ose me priftin/hoxhën/pastorin e kultit tënd, na kontakto në numrin e telefonit 376.0135353 email: oltreemergenza@gmail.com

ÇFARË DUHET BËRË NËSE PERSONI KA VDEKUR NË SHTËPI?

Në rast “dyshimi për vdekje”, familiari, pasi vlerëson situatën, telefonon në numrin 118 ose i telefonon Mjekut të përgjithshëm apo Mjekut të turnit.

Rrethi i Parmës: telefoni 0521 292555

Rrethi i Fidencës: telefoni 0524 515620

Rrethi Jug-Lindje: telefoni 0521 857454

Rrethi Valli Taro dhe Ceno: telefoni 0525 970353

SI DUHET VEPRUAR PËR TË MARRË SENDET PERSONALE TË NJË PERSONI TË DASHUR QË KA NDRUAR JETË NGA COVID-19 NË SPITAL?

Një grup profesionistësh është duke u marrë me organizimin e dorëzimit të sendeve personale të të sëmurëve që kanë ndëruar jetë në spital. Do të kontaktohesh personalisht për të caktuar një takim që do të mbahet në pavionin Rasori. Atje, do të të dorëzohen sendet personale të të afërmit tënd, që ndërkohë janë ruajtur në një ambient të mbrojtur dhe të sigurt.

KU MUND TË KËRKOHET ÇERTIFIKATA E VDEKJES?

Çertifikata e vdekjes duhet të kërkohet në Komunën e Parmës. Tel 0521 4 0521 e-mail; 052140521@comune.parma.it , urp@comune.parma.it fax 0521 405214, ose në Komunën e vendbanimit, në rastin kur vdekja ka ndodhur në Komunën e vet. Në të gjitha rastet, mund t'i drejtoheni zyrës së gjendjes civile të Komunës tuaj.

ÇFARË DUHET BËRË NËSE NDJENI NEVOJËN PËR NJË NGUSHËLLIM SHPIRTËROR?

Nëse keni nevojë për t'u vënë në kontakt me [priftin/hoxhën/pastorin](#) e kultit tënd për një ngushëllim shpirtëror, na kontaktoni në numrin e telefonit 376.0135353 email: oltreemergenza@gmail.com dhe ne do të të vëmë në kontakt.

Kujt duhet t'i drejtoheni

KUJT DUHET T'I DREJTOHENI NËSE DYSHONI SE KENI SINTOMAT E KORONAVIRUSIT?

Për vlerësimin e simptomave të Koronavirusit, pikat referuese janë mjeku juaj i familjes, mjeku i rojes dhe numrin e telefonit 118: rekomandimi është që të mos spostoheni nga shtëpia dhe të kontaktoni me telefon një nga këto shërbime. Mund t'i telefononi **numrit 1500** të Ministrisë ose numrit të Departamentit të Shëndetit Publik të AUSL Parma **0521 396436**. Numri është aktiv nga e hëna në të premte 8.30-13/14-18 dhe të shtunën 8.30-13. Qarku i Emilia-Romanjës ka vënë në dispozicion numrin e gjelbër 800.033.033, i cili nga data 29 shkurt është aktiv 7/7 ditë, nga ora 08.30 deri në 18 për të marrë informacionet shëndetësore.

Numrat e Telefonit të Mjekut të Rojes

Rrethi i Parmës: telefoni 0521 292555

Rrethi i Fidencës: telefoni 0524 515620

Rreth Jug-Lindje: telefoni 0521 857454

Rrethi Valli Taro dhe Ceno: telefoni 0525 970353

KUJT DUHET T'I DREJTOHENI NË RASTIN E NJË TË SËMURI QË KA SHKUAR NË URGJENCË?

Nëse nuk merr informacione direkt nga Urgjenca ose nga reparti, mund të kontaktosh Zyrën e Marrëdhënieve me Publikun në numrin e telefonit [0521 703174](tel:0521703174) çdo ditë – përfshirë të shtunën dhe të dielën – nga ora 8.00 deri në 20.00. Profesionistët e URP do të kërkojnë të afërmin tuaj dhe do të kontaktojnë me mjekun dhe do të japin informacionet. Këta profesionistë janë në gjendje edhe të thonë se ku ndodhet i afërti yt. Në rast urgjence është aktiv 24/24 orë edhe shërbimi telefonik i centralit të Spitalit në numrat e telefonit [0521 702111](tel:0521702111) – [0521 703111](tel:0521703111) . Kur telefonon, mos harro të përgatitësh numrin tënd të telefonit në mënyrë që të rikontaktojnë. Ka mundësi që në fillim mund të thonë se ku gjendet familjari yt dhe se në çfarë reparti ndodhet. Më pas, mjeku do të kontaktojë për të dhënë disa informacione klinike për gjendjen e tij shëndetësore. **Asnjëherë nuk duhet të shkosh në Urgjencë: edhe në këtë moment kaq të ndërlikuar dhe të vështirë, rregulli është të qëndrosh në shtëpi.**

KUJT DUHET T'I DREJTOHENI PËR TË DITUR NËSE FAMILIARI ËSHTË SHTRUAR NË SPITAL?

Sapo të jetë shtruar në spital, të nesërmen e mbërritjes në repart, mjeku kontakton familjen për t'i dhënë informacione për kushtet shëndetësore. Kontakti bëhet zakonisht në orët e pasdites. Nëse merrni telefonatën, telefonojini gjithmonë Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun urp nga ora 8 deri në 20, çdo ditë: [0521.703174](tel:0521.703174) ose urp@ao.pr.it.

KUJT DUHET T'I DREJTOHENI NËSE KENI NEVOJË PËR USHQIME APO NUK MUND TË LËVIZNI NGA SHTËPIA?

Për shtetasit që ndodhen në kushte nevojë për ushqime dhe nuk mund të lëvizin nga shtëpia për të bërë pazar dhe për këtë arsye kanë nevojë për një shërbim pazari/ushqimesh, Komuna e Parmës ka organizuar një sistem, paralelisht me atë të lidhur me fuqizimin e asistencës në shtëpi, që garanton dorëzimin në shtëpi të ushqimeve, ilaçeve dhe pakove me ushqime.

Numri operativ është aktiv nga e hëna në të premte nga ora 8.30 deri në 17:30: tel. 0521.218970 ose 339.6859982. Jashtë këtyre orareve mund të kontaktohet numri i gjelbër i SEIRS CROCE GIALLA 800112822.

KUJT DUHET T'I DREJTOHENI NËSE KENI NEVOJË URGJENTE PËR ILAÇE?

Për dorëzimet URGJENTE (brenda 24/48 orësh) të ilaçeve, që mund të blihen në farmacitë e territorit ose që mund të gjenden pranë qendrës farmaceutike AUSL në Spital, mund të kontaktoni Kryqin e Kuq në numrin e telefonit 334 7516023. Dorëzimi është falas.

KUJT DUHET T'I DREJTOHENI PËR INFORMACIONE ME NATYRË SHËNDETËSORE NË PROVINCËN E PARMËS?

Është i disponueshëm numri **0521 396436** i Ausl Parma, i dobishëm edhe për të marrë informacione të përgjithshme për virusin, për simptomat dhe për përkujdesjet për të luftuar përhapjen. Numri është aktiv nga e hëna në të premte 8.30-13/14-18 dhe të shtunën 8.30-13.

Qarku i Emilia Romanjës ka vënë në dispozicion **numrin e gjelbër 800.033.033**, i cili nga data 29 shkurt është aktiv 7/7 ditë, nga ora 08.30 deri në 18 **për të marrë informacione me natyrë shëndetësore**.

KUJT DUHET T'I DREJTOHET CILIQO QË HYN NË ITALI?

Cilido që ka hyrë në Itali, duhet t'ia komunikojë këtë rrethanë Departamentit të parandalimit të Ndërmarrjes USL kompetente për territorin. Departamenti i Shëndetit Publik i Ausl Parma ka vënë në dispozicion **adresën email quarantena_rientri_covid19@ausl.pr.it** al tek e cila **duhet të komunikohen informacionet**

e mëposhtme: emri dhe mbiemri i qytetarit, vendi nga ka ardhur, mjete të transportit, adresa ku ka vendbanimin apo vendqëndrimin (në komuna e Parmës dhe provincës), një adresë email dhe një numër telefoni ku të kontaktoheni, kushtet e përgjithshme të shëndetit (prania e simptomave të lidhura me infeksionin si p.sh. temperaturë, kollë, e ftohur, vështirësi në frymëmarrje).

Ku mund të shkosh për ... (shërbime të nevojshme)

NËSE NUK KE NJË VEND KU MUND TË HASH DHE KE NEVOJË PËR NJË VAKT TË GATSHËM MUND TË SHKOSH:

MENSA E DELLA FRATERNITA' në Parma në Rrugën: via Turchi 10, tel. dhe fax 0521 570490.

Oraret e hapjes: nga e hëna në të shtunë, nga ora 12 deri në orën 12,45 dhe nga ora 18 deri në orën 18,30; të dielën nga ora 12 deri në orën 12,45. Prenotimi pranë Karitasit dioqezan, në Parma, në katin e parë të sheshit Duomo 3, nga e hëna në të premte, nga ora 8,30 deri në orën 12 dhe nga ora 15 deri në orën 18, të shtunën nga ora 8,30 deri në orën 12.

MENSA PADRE LINO, në Parma në Rrugën: via Imbriani 6/a Oraret e hapjes: çdo ditë nga ora 12..

Prenotimi pranë Karitasit dioqezan, në Parma, në katin e parë të sheshit Duomo 3, nga e hëna në të premte, nga ora 8,30 deri në orën 12 dhe nga ora 15 deri në orën 18, të shtunën nga ora 8,30 deri në orën 12.

MENSA E KOMUNITETIT ISLAMIK NË PARMA, Gjatë muajit të Ramazanit do të jetë aktiv edhe shërbimi i mensës pranë Komunitetit Islamik të Parmës dhe Provincës në Rrugën Via P. Campanini, 6 Parma Tel. 0521 786778 e-mail: islam.parma@gmail.com

MUND T'I DREJTOHENI EDHE.

Qendrës së dëgjimit të Karitasit dioqezan në Parma në adresën Sheshi Duomo 3 e hapur çdo ditë pune nga ora 8,30 deri në orën 12,30 dhe nga ora 15 deri në orën 18.

Nëpërmjet bisedës paraprake mund të keni akses në shërbimet e mëposhtme:

- Shpërndarje e çantave me ushqime;
- Hyrje në fjetoren e komunës për meshkuj dhe femra;
- Hyrje në fjetoren e Karitasit;
- Ndërhyrje emergjence;
- Rregjistrim në shkollën e italishtes për të huaj

NËSE KENI NEVOJË PËR SHËRBIMIN E LARJES DHE PASTRIMIT.

Qendra Karitas, në Parma në Rrugën via Turchi 10. Ju dorëzohet gjithshka është e nevojshme për dushin dhe për ndrimin e të brendshmeve.

Burrat: nga e hëna në të shtunë **nga ora 8 deri në orën 9.**

Gratë: nga e hëna në të shtunë **nga ora 9,15 deri në orën 10.**

NËSE KENI NEVOJË PËR KURIME MJEKËSORE DHE NUK KENI NJË MJEK KU TË SHKONI.

Kush ka nevojë për kurime mjekësore mund t'i drejtohet Hapësirës së Shëndetit për Emigrantët, në Parma në Rrugë via XXII luglio 27 , kati 3°, tel. 0521 393431, **të martën** nga ora 11 deri në orën 17, **të mërkurën** vetëm me takim, **të enjten** nga ora 8,30 deri në orën 11,30 dhe **të premten** nga ora 9 deri në orën 12. Shërbimi i jepet edhe personave që nuk janë të pajisur me leje qëndrimi apo atyre që u ka skaduar leja e qëndrimit.

Kush ka nevojë për dentist, por vetëm për urgjencat, mund t'i drejtohet **Qendrës shëndetësore Basetti**, në Parma në Rrugën viale Basetti 8 **nga e hëna në të shtunë** nga ora 7,30 në orën 9,30. Do të vizitohen vetëm 6 pacientët e parë; nevojitet që të tërhiqet numri.

NËSE KENI NEVOJË PËR VESHJE DREJTOHUNI TEK:

Cilido ka nevojë për t'u veshur, mund t'i drejtohet Karitasit ose Dollapit të të varfrit dhe të solidaritetit :

Karitasi dioqezan, në Parma në Sheshin Duomo, 3 – kopshti i brendshëm
Lëshimi i tesrave: pranë Karitasit – kati 1°.

Dollapi i të varfrit dhe i solidaritetit, në Parma pranë famullisë Santissima Annunziata, me hyrje nga kopshti i Borgo Fornovo në anën e majtë të vetë famullisë.

PËR INFORMACIONE PËR LEJEN E QËNDRIMIT DHE PRAKTIKAVE DREJTOHUNI TEK:

Shërbimi “Informa stranieri” (Informim i të huajve) i Komunës së Parmës në Rrugën via A. Cecchi, 3 në Parma

tel. 0521-031060 mail: informastranieri@comune.parma.it

Shërbimi i dedikohet shtetasve me vendbanim ose me vendqëndrim në Komunitat e mëposhtme: Parma, colorno, Mezani, Sorbolo dhe Torrile

PËR T'U DËGJUAR, MUND T'I DREJTOHENI:

AUSL PARMA

Koronavirus: shërbimet falas AUSL për mbështetje psikologjike për të përballuar emergjencën: dërgoni një mesazh Sms në numrin e telefonit 351 7968660 ose shkruani një email në adresën info@sipem-er.it, duke dhënë një numër telefoni tek i cili të mund të kontaktoheni.

TELEFONI AMICO PARMA

Nga ora 17 deri në orën 23 çdo ditë në numrin e telefonit 0521 284344

SHOQATA E PROMOVIMIT SOCIAL LGBT “Ottavo Colore”

Të martën mund të kontaktoni Federico 3454139554
Të enjten mund të kontaktoni Valeria 3475703226
Të premten mund të kontaktoni Valentina 3293283534
nga ora 17.00 deri në orën 19.00.

Për urgjencat na shkruani këtu ose në adresën email ottavocolore@gmail.com

SHOQATA MANOS SIN FRONTERAS

Vullnetarët Manos përgjigjen çdo ditë në numrat e dhënë në fletushkën bashkëngjitur, duke u mësuar personave një praktikë të thjeshtë frymëmarrje dhe meditimi që ndihmon për të kapërcyer gjendjet e ankthit dhe të stresit. Personi referues në Parma: Marialuisa - 3389712455

NDIHMË PSIKOLOGJIKE

Një **mbështetje njerëzore dhe profesionale** mund të ketë një rol me rëndësi shumë të madhe në **administrimin e dhimbjes dhe të izolimit**. Nëpërmjet këtyre bashkëbisedimeve ofrohet një ngushëllim dhe inkurajim duke ndihmuar personat që të përpunojnë përvojën e dhimbshme duke u munduar të nxjerrin **burimet personale** thelbësore për të përballuar jetën e përditshme.

Ofrojmë një **shërbim bashkëbisedimesh psikologjike FALAS**

Stafi ynë i psikologëve dhe Këshilltarëve përgjigjet direkt nga numri i vet i celularit:

Dr. Ilaria De Amicis, Psikologa, të Hënën nga ora 16 deri në orën 18 cel. 328 3066844

Dr. Maria Angela Gelati, Tanatologe, Death Educator e Lehtësuese e grupeve dhe Laboratorëve Mbështetës për humbjen e të afërmeve, të Premten nga ora 15 deri në orën 16, cel. 335 6140819

Dr. Enrico Rossi Psicologo, të Mërkurën nga ora 8,30 deri në orën 10,30, cel. 347 888 5548

Valeria Savazzi, Counsuelor Humaniste e specializuar për humbjen e të afërmeve, për mbështetje emotive, të Martën nga ora 16 deri në orën 18, cel.347 5703226

Dr. Ursula Zambelli, Psikolog, të premten nga ora 11 deri në orën 13 cel. 340 2525639

NGUSHËLLIM SHPIRTËROR

Ngushëllimi shpirtëror bën pjesë në gjërat thelbësore të personave. Kjo gjë merr vlerë veçanërisht në momentet e emergjencës, si kjo aktualja. Dhe vlen veçanërisht për personat më të ndjeshëm, si të moshuarit, të sëmurët, të paaftët, personat e vetmuar dhe tipologjitë e ndryshme të mërgimtarëve socialë.

Në këtë situatë, lutja mund të jetë një ngushëllim i madh. **Nëse ke nevojë për një takim me kapelanin, priftin, imamin, pastorin, apo përfaqësuesit e tjerë fetarë apo laikë**, mund të të ndihmojmë që të viresh në kontakt me një nga këto figura.

Për të lënë një takim, na kontaktoni

Telefonoji numrit 376.0135353 ose na shkruani në adresën oltreemergenza@gmail.com

LINKE TË DOBISHËM

NUMRA TË DOBISHËM

Ministria e Shëndetësisë: Tel. 1500

Departamenti i Shëndetit Publik i AUSL Parma: Tel. 0521 396436. Numri është aktiv nga e hëna në të premte 8.30-13/14-18 dhe të shtunën 8.30-13.

Numri i gjelbër i Qarkut të Emilia Romanjës: 800.033.033 aktiv 7/7 ditë, nga ora 08.30 në orën 18 për të marrë informacione shëndetësore.

Në rast urgjencash, natyrisht, qëndron gjithmonë aktiv numri 118.

FAQE INTERNETI TË DOBISHME

Në rast dyshimesh, konsulto vetëm burime të besueshme si:

Qeveria:

<http://www.governo.it> / <http://www.governo.it/it/approfondimento/coronavirus/13968>

Ministria e Shëndetit:

<http://www.salute.gov.it> / <http://www.salute.gov.it/nuovocoronavirus>

Instituti i Lartë i Shëndetësisë: www.iss.it / <https://www.epicentro.iss.it/coronavirus/>

AUSL Parma:

www.ausl.pr.it / https://www.ausl.pr.it/comunicazione_stampa/archivio_3/nuovo_coronavirus_tutto_quello_sapere.aspx

Komuna e Parmës:

www.comune.parma.it

Qarku Emilia Romanja:

<http://www.regione.emilia-romagna.it/coronavirus>

Gazeta Zyrtare: <https://www.gazzettaufficiale.it/dettaglioArea/12>

Zyrat “Informa stranieri”

Parma: https://www.comune.parma.it/informastranieri/Pages/entry_informastranieri.aspx

BASHKËPUNTORË

Projekti zhvillohet në bashkëpunim me realitetet e shumta, për t'i dhënë mundësi personave të shumtë që të përfaqësohen dhe të mbështeten e ngushëllohen në mënyrën e përshtatshme.

Ato janë **Forumi Ndërfetar i Parmës**, Komunitetet e mëposhtme Fetare apo Shpirtërore apo Shoqatat:

- Shoqata Shqiptare Skanderbeg
- Asamblea Shpirtërore Lokale Baha'i
- Shoqata The Ahmadiyya Muslim Jama'at Itali Parma
- Shoqata Gurdwara Singh Sabha Komuniteti Sikh
- Shoqata Oltre Il Ponte
- Bashkimi Induist Italian, Polesine Parma
- Kisha e Krishterë Aventiste e ditës së shtatë Parma
- Kisha Evangjelike Metodiste e Parmës,
- Rrethi Uaar Parma,
- Komuniteti Islamik i Parmës
- Soul Winning Evangelical Mission në Parmë
- Zoe Pentecostal Mission në Parma
- Famullia Greko Ortodokse San Nectario
- Famullia Ortodokse Rumune e SS.Elisabetta e Zaccaria

Me bashkëpunimin e Ndërmjetëses Gjuhësore Kulturore Dr. Kristen Xiaowei Xu për gjuhën kinezishte.

Shoqata Armonia e Ndoj Agency

Falenderohen për bashkëpunimin e zellshëm në dhënien e informacioneve të gjitha zyrat e Ndërmarrjes Njesisë Shëndetësore Lokale të Parmës.